

**PLANI FINANCIAR  
I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE  
PËR VITIN 2022**

**Shkup, mars 2022**

<b>PËRMBAJTJA</b>	
<b>PËRMBAJTJA</b> .....	<b>2</b>
<b>I. H Y R J E</b> .....	<b>3</b>
<b>II. BAZAT E PLANIT FINANCIAR TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË VITIN 2022</b> .....	<b>6</b>
II.1 DINAMIKA E PLANIFIKUAR E LËVIZJES SË BAZËS SË DEPOZITAVE TEK ANËTARET E FONDIT NË PJESËN E MJETËVE TË POPULLATËS GJATË VITIT 2022 .....	7
<b>III. REZULTATET E PLANIFIKUARA TË BILANCIT TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË 2022..</b>	<b>12</b>
III.1 BILANCI I GJENDJES .....	12
III.2 PLANI I BILANCIT TË SUKSESIT PËR PERIUDHËN 01.01 DERI MË 31.12.2022.....	16
<b>1.1. TË ARDHURA</b> .....	<b>16</b>

## I. HYRJE

Fondi i Sigurimit të Depozitave është institucion shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i themeluar në 1997 me ligj të veçantë dhe funksionon si një institucion financiar jo-buxhetor, vetë-financues, fitimprurës, institucion financiar i specializuar. Qëllimi i ekzistimit të Fondit është sigurimi i depozitave të popullsisë dhe kompensimi i depozitave të siguruara në banka, degë të bankave të huaja, shtëpi kursimesh në rast të ndodhjes së një ngjarjeje të rrezikshme. Fondi është regjistruar me veprimtari në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare (65.12 sigurime jo-jetësore).

Detyra kryesore e Fondit është të sigurojë depozitat e popullsisë në sektorin bankar në vend dhe të disponojë me ndërgjegje dhe produktivitet me mjetet të cilat i mbledh nga bankat, degët e bankave të huaja dhe shtëpitë e kursimeve në bazë të premive për sigurimin e depozitave, me çka mundëson shtimin e mjeteve dhe forcimin e vazhdueshëm të fondeve të sigurisë, të cilat përdoren për të kompensuar depozituesit në rast se Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut merr lejen e punës për një bankë, degë të një banke të huaj ose shtëpi kursimi, dmth. në rast të ndodhjes së një ngjarjeje rreziku.

Fondi i Sigurimit të Depozitave është një nga shtyllat më të rëndësishme në ruajtjen e stabilitetit financiar, së bashku me institucionet e tjera që marrin pjesë në krijimin dhe drejtimin e politikës fiskale dhe monetare të vendit. Prandaj, pjesëmarrja e tij në analizat sistematike është e rëndësishme, parashikimet dhe simulimet e ngjarjeve të mundshme me rrezik me qëllim që të garantojë sigurinë e depozitave të qytetarëve.

Plani Financiar i Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2022 u krijua me qëllim që të organizojë dhe zbatojë në mënyrë efikase aktivitetet që janë të rëndësishme për realizimin e dy proceseve bazë për të cilat u themelua Fondi, si dhe me qëllim të modernizimit të tyre, për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve të Fondit. Gjatë vitit 2022, Fondi do të vazhdojë të zbatojë aktivitete promovuese që do të kontribuojnë në ngritjen e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin e publikut për ekzistencën e një sistemi të sigurimit të depozitave, i cili do të forcojë besimin në sistemin bankar, i cili është shtyllë e zhvillimit të ekonomisë në shtet.

Investimet, si një nga aktivitetet kryesore të Fondit, do të vazhdojnë të zbatohen në përputhje me politikat e investimeve për ruajtjen e një portofoli investimesh të fortë, me rrezik të ulët dhe portofol investues të sigurt.

Gjatë vitit 2022, Fondi do të vazhdojë të përforcojë bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, Forumin Evropian të Siguruesve të Depozitave dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave. Gjithashtu është planifikuar ruajtja e bashkëpunimit të suksesshëm me të gjitha institucionet dhe organizatat e rëndësishme vendase në sektorin financiar dhe bankar. Fondi i Sigurimit të Depozitave do të punojë në aktivitete që korrespondojnë me politikat e reja evropiane të sigurimit të depozitave.

Qëllimi përfundimtar i të gjitha aktiviteteve të cilat i zbaton Fondi është përforcimi dhe modernizimi i sistemit të sigurimit dhe dëmshpërblimit të depozituesve si dhe afrimi me Direktivën Evropiane për Sigurimin e Depozitave (DIREKTIVA 2014/49 / EU).

Për realizimin e aktiviteteve afariste, gjatë përgatitjes së Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2022, janë marrë parasysh parametrat e mëposhtëm: a) legjislacioni aktual; b) Politikat ekonomike të Qeverisë, treguesit makroekonomik dhe parashikimet për vitin 2022; c) përforcimin e bashkëpunimit rajonal dhe bashkëpunimit me shtetet e zhvilluara evropiane me qëllim të përafritimit me trendet evropiane; d) përforcimin e bashkëpunimit me BPRMV, Ministrinë e Financave, Shoqatën e Bankave të Maqedonisë dhe institucione të tjera financiare dhe bankare të rëndësishme për ruajtjen e stabilitetit financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## I. Skenari makroekonomik për vitin 2022 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Pandemia botërore, kriza shëndetësore dhe ekonomike e cila filloi në vitin 2020 për arsye të përhapjes së smundjes infektuese COVID 19, vazhdoi edhe në vitin 2021.

Në gjysmën e dytë të vitit 2021 filloi edhe vaksinimi masiv për mbrojtje nga virusi SarsCov2, proces ky që hapi mundësinë e luftimit të pandemisë dhe rimëkëmbjen e ngadalshëme të dëmeve të cilët i shkaktoi e njejtja.

Pas rënies prej 4,5% të BPV në vitin 2020, Banka Popullore në vitin 2021 parashikon rimëkëmbjen e ekonomisë dhe rritjen e volitshëme të BPV prej 3,9%. Në afat të mesëm parashihet rimëkëmbje, me shkallë rritje rreth 4%. Kjo dinamikë e rritjes gjatë vitit 2022 do të mundësoj kompenzimin e humbjeve ekonomike nga korono-kriza duke tejkaluar në nivelin e parapandemisë<sup>1</sup>.

Projektimet e inflacionit në vitin 2021 parashikojnë që të jenë 3,1%, ndërsa në vitin 2022 parashikohet ulje prej 2,4%, dhe më tej ruajtje të mesatares historike prej rreth 2%. Faktor të cilët ndikojn në rritjen e normës së inflacionit kryesisht janë të natyrës globale – rritje e çmimeve botërore të prodhimeve primare(bazë) dhe prishje të zingjirëve global të furnizimit<sup>2</sup>.

Në hartimin e Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2022, më të rëndësishme janë lëvizjet e depozitave të popullatës të cilat i siguron dhe të kompenzon Fondi i Sigurimit të Depozitave dhe faktorët e tjerë siç janë:

- Parashikimet për zhvillimet makroekonomike dhe politikën monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022;
- Dinamika e planifikuar e lëvizjes së depozitave të popullatës në sektorin bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022;
- Dinamika e planifikuar mujore e lëvizjes dhe gjendja e portofolit të investimeve të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2022;
- Rezultatet e vlerësuara të bilancit në vitin 2022.

Gjatë vitit 2022, Fondi i Sigurimit të Depozitave do të vazhdojë të kryejë aktivitetet e rregullta afariste përmes së cilave realizohen qëllimet e tij themelore, strategjitë dhe misioni për të cilin është krijuar, duke marrë parasysh zbatimin e masave dhe aktiviteteteve për një funksionim efikas dhe efektiv, evaliumin e qëllimeve të arritura dhe vendosja e një shkalle të lartë të kontrollit mbi punën. Njëkohësisht, Fondi i Sigurimit të Depozitave planifikon të kryejë aktivitete të caktuara përgatitore në mënyrë që të afrohet me politikat e reja të BE-së në fushën e sigurimit të depozitave të popullatës.

---

<sup>1</sup> Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>2</sup> Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

## II. Bazat e Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2022

Gjatë përgatitjes së Planit financiar të Fondit të Sigurimeve, u morën parasysh gjendja e depozitave sipas muajve, dinamika e lëvizjes së depozitave, struktura e monedhës dhe struktura e maturimit të depozitave të popullatës në sektorin bankar në vitin 2021, në bazë të së cilit ishte përgatitur parashikim për dinamikën e lëvizjes së depozitave të popullsisë në vitin 2022.

Projeksioni i caktuar i lëvizjes së depozitave të popullsisë për sektorin bankar në vitin 2022 mundësoi përgatitjen e një parashikimi relativisht të saktë të të hyrave në Fond gjatë vitit 2022 në bazën të mbledhjes së premeve të sigurimit, ndërsa parashikimi i të hyrave në Fond mundësoi planifikimin e investimeve të Fondit për vitin 2022.

Prandaj, plani financiar për vitin 2022 bazohet në parametrat e mëposhtëm:

- Depozitat e popullatës në sektorin bankar në fund të vitit 2022 do të arrijnë një rritje vjetore prej 7% dhe do të arrijnë shumën prej 336,832 milion denarë;
- Fondi në fund të vitit 2022 do të mbledhë premijë totale vjetore në vlerë prej 808 milion denarë;
- Vëllimi i portofolit të investimeve në fund të vitit 2022 parashikohet ta tejkalojë me 5.8% vëllimin e realizuar në fund të vitit 2021;
- Në bazë të kamatës për bonot shtetërore (normë iteresi prej 0.5%) në vitin 2022 Fondi do të realizojë 38,016 mijë denarë dhe, për bankat ndërmjetsuese do të paguajë provizion në vlerë prej 525 mijë denarë për ndërmjetësimin në blerjen e bonove.

Fondi i Sigurimit të Depozitave, në cilësinë e kredituesit në procedurën e falimentimit të „Eurostandard Bankë” SHA Shkup në falimentim, gjatë vitit 2022 pret që të paguhen kërkesat e tij. Gjatë realizimit të pagesës së kërkesave, Fondi menjëherë do t'i deponoj mjetet në fondin e sigurisë dhe do ti përfëshin ata në mënyrë adekuade në portofolin e tij investues.

Parametrat e mësipërm janë elaboruar në mënyrë të detajuar në seksionet 2.1 dhe 2.2 të Kapitullit 2 të Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për 2022.

## II.1 Dinamika e planifikuar e lëvizjes së bazës së depozitave tek anëtarët e Fondit në pjesën e mjetëve të popullatës gjatë vitit 2022

Dinamika e planifikuar e lëvizjes së bazës së depozitave të anëtarëve të Fondit në vitin 2022 bazohet në vlerësime reale nga ana e Fondit dhe parashikohet rritja vjetore e masës së depozitës prej 7%, gjegjësisht depozitat e popullatës në total në fund të vitit 2022 të arrijnë në 336,832.100 mijë denarë (Tabela 1).

Tabela 1: Dinamika e planifikuar e rritjes së depozitave dhe bilanci i planifikuar mujor i depozitave totale të popullatës në vitin 2022 në korrelacion me bilancin e realizuar mujor të depozitave dhe dinamika e realizuar e rritjes së depozitave në vitin 2021

në mijëra denarë


Data	Depozita të vitit 2021 <i>gjendja reale</i>	Dinamika e planifikuar e rritjes së depozitave në vitin 2021 (në %)	Dinamika e realizuar e rritjes së depozitave në vitin 2021 (në %)	Data	Depozita të planifikuara për vitin 2022	Dinamika e planifikuar e rritjes së depozitave për vitin 2022
31.12.2020	295.686.631			31.12.2021	314.750.858	
31.01.2021	296.122.887	-0,40%	0,15%	31.01.2022	315.380.360	0,20%
28.02.2021	299.961.877	0,90%	1,30%	28.02.2022	319.480.304	1,30%
31.03.2021	300.706.003	0,05%	0,25%	31.03.2022	320.279.005	0,25%
30.04.2021	301.169.505	0,60%	0,15%	30.04.2022	320.919.563	0,20%
31.05.2021	302.361.953	0,30%	0,40%	31.05.2022	322.524.161	0,50%
30.06.2021	303.174.255	0,80%	0,27%	30.06.2022	323.394.976	0,27%
31.07.2021	304.236.475	0,50%	0,35%	31.07.2022	324.526.859	0,35%
31.08.2021	306.964.382	0,40%	0,90%	31.08.2022	327.447.600	0,90%
30.09.2021	308.302.103	0,50%	0,44%	30.09.2022	328.888.370	0,44%
31.10.2021	308.409.608	0,20%	0,03%	31.10.2022	329.875.035	0,30%
30.11.2021	310.099.368	0,60%	0,55%	30.11.2022	331.854.285	0,60%
31.12.2021*	314.750.858	1,50%	1,50%	31.12.2022	336.832.099	1,50%
<b>Gjithsej</b>		<b>6,1</b>	<b>6,4%</b>			<b>7%</b>

\* shuma dhe përqindja e rritjes së shprehur për muajin dhjetor viti 2021 jepen si pritje (projektim) për arsye se në momentin e përgatitjes së planit financiar për vitin 2022 nuk ka të dhëna reale të disponueshme për analizë.

Në pajtim me rritjen e realizuar të depozitave në vitin 2021 dhe indikatorëve makroekonomikë të treguar mësipër në vitin 2022, për vitin 2022 është projektuar rritje vjetore e bazës së depozitës prej 7%, e cila në baza mujore do të karakterizohet me rritje deri në fund të vitit 2021.

Trendi mujor i lëvizjes së depozitave në vitin 2021 dhe i planifikuari për vitin 2022 është dhënë në Grafikon1.

Grafiku 1: Dinamika e depozitave të popullatës për vitin 2021 dhe projektimi i dinamikës së depozitave të popullatës për vitin 2022



Sipas lëvizjes së projektuar të depozitave për vitin 2022, parashikohet që Fondi të mbledhë shumën totale të premisë prej 808,191,955.00 denarë deri në fund të vitit 2022. (Tabela 2).

Tabela 2: Mbledhja e pritshme e premisë nga anëtarët e Fondit dhe niveli i mbulimit të Fondit gjatë vitit 2022

*në denarë*

Data	Gjendja e parashikuar e depozitave gjatë vitit 2022	Norma e premisë (%)	Shuma mujore e premisë	Niveli i mbulimit (target ratio)
31.12.2021	314.750.858.520			
31.01.2022	315.380.360.237	0,25	65.573.096	<b>4.84</b>
28.02.2022	319.480.304.920	0,25	65.704.242	<b>4.80</b>
31.03.2022	320.279.005.682	0,25	66.558.397	<b>4.81</b>
30.04.2022	320.919.563.694	0,25	66.724.793	<b>4.82</b>
31.05.2022	322.524.161.512	0,25	66.858.242	<b>4.82</b>
30.06.2022	323.394.976.748	0,25	67.192.534	<b>4.83</b>
31.07.2022	324.526.859.167	0,25	67.373.953	<b>4.83</b>
31.08.2022	327.447.600.899	0,25	67.609.762	<b>4.81</b>
30.09.2022	328.888.370.343	0,25	68.218.250	<b>4.81</b>
31.10.2022	329.875.035.454	0,25	68.518.410	<b>4.81</b>
30.11.2022	331.854.285.667	0,25	68.723.966	<b>4.81</b>
31.12.2022	336.832.099.952	0,25	69.136.310	<b>4.75</b>
<b>Premija e përgjithshme vjetore për 2022</b>			<b>808.191.955</b>	



## **II.2 Dinamika e planifikuar mujore e lëvizjes dhe gjendja e portofolit të investimeve të Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2022**

Në përputhje me Ligjin për Fondin e Sigurimit të Depozitave edhe në vitin 2022, Fondi do t'i plasojë mjetet e mbledhura në letrat me vlerë – bono thesari me vlerë me afat maturimi prej 364 ditësh, sipas kalendarit të ankandëve mujore për vitin 2022, të shpallur nga Ministria e Financave. Mënyra e investimit të mjeteve bëhet sipas dispozitave të akteve të brendshme të Fondit - Rregullorja për politikën e investimeve të Fondit.

Gjatë përgatitjes së planit të portofolit të investimeve të Fondit për vitin 2022, u vërtetuan supozimet e mëposhtme:

- 7% rritje vjetore e depozitave të përgjithshme te anëtarët e Fondit;
- 0,25% norma vjetore e premisë; dhe
- 0,50% norma e interesit në nivel vjetor për bonot shtetërore dymbëdhjetë mujore

Fondi do t'i plason mjetet në të holla nga pagesa e premisë nga anëtarët e Fondit dhe të ardhurat në bazë të plasmaneve në letra me vlerë.

Premia totale në vitin 2022 do të arrijë 808 mijë denarë, që paraqet hyrje bazë për ri-investim, gjegjësisht për blerjen e bonove të reja, së bashku me shumën e bonove të maturimit të arritur në secilin muaj të vitit.

Bilanci i përgjithshëm i portofolit të investimeve në fund të vitit 2022 planifikohet të arrijë në 15.620 milion denarë (vlera aktuale, 15.589 milion denarë), që paraqet rritje prej 850 mijë denarë, gjegjësisht rritje prej 5.8% krahasuar me vitin 2021. Dinamika dhe vlerat nominale të bonove shtetërore me afat maturimi të arritur dhe bonove shtetërore të planifikuara sipas muajve në vitin 2022 është treguar në Tabelën 3.

Tabela 3: Plani i portofolit të investimeve të Fondit për vitin 2022

në denarë

- 2022 година (месеци) - 12 месечни државни записи	Достасани записи	Нови записи	Каматна стапка	Камата			Провизија за банка- купувач
	во номинална вредност			камата до 31.12.2022	камата во 2023	вкупно камата до доспевање	
<b>состојба на 31.12.2021</b>	<b>14.770.000.000</b>						
јануари	600.000.000	660.000.000	0,50%	3.091.792	228.008	3.319.800	35.000
	<b>14.830.000.000</b>						
февруари	760.000.000	830.000.000	0,50%	3.727.589	447.311	4.174.900	35.000
	<b>14.900.000.000</b>						
март	3.040.000.000	3.110.000.000	0,50%	13.064.734	2.578.566	15.643.300	35.000
	650.000.000	650.000.000	0,50%	2.479.071	2.089.129	4.568.200	35.000
	<b>14.970.000.000</b>						
април	1.230.000.000	1.300.000.000	0,50%	4.706.643	1.832.357	6.539.000	35.000
	<b>15.040.000.000</b>						
мај	1.040.000.000	1.110.000.000	0,50%	3.589.264	1.994.036	5.583.300	35.000
	<b>15.110.000.000</b>						
јуни	520.000.000	590.000.000	0,50%	1.622.451	1.345.249	2.967.700	35.000
	<b>15.180.000.000</b>						
јули	60.000.000	130.000.000	0,50%	307.189	346.711	653.900	35.000
	<b>15.250.000.000</b>						
август	380.000.000	450.000.000	0,50%	932.761	1.330.739	2.263.500	35.000
	<b>15.320.000.000</b>						
септември	0	60.000.000	0,50%	95.349	206.451	301.800	35.000
	<b>15.380.000.000</b>						
октомври	720.000.000	800.000.000	0,50%	884.396	3.139.604	4.024.000	35.000
	1.560.000.000	1.560.000.000	0,50%	1.422.771	6.424.029	7.846.800	35.000
	<b>15.460.000.000</b>						
ноември	2.170.000.000	2.250.000.000	0,50%	1.399.141	9.918.359	11.317.500	35.000
	1.010.000.000	1.010.000.000		432.663	4.647.637	5.080.300	35.000
	<b>15.540.000.000</b>						
декември	1.030.000.000	1.110.000.000	0,50%	260.759	5.322.541	5.583.300	35.000
	<b>15.620.000.000</b>						
<b>Вкупна состојба на 31.12.2021</b>	<b>15.620.000.000</b>			<b>38.016.573</b>	<b>41.850.727</b>	<b>79.867.300</b>	<b>525.000</b>
<b>Сегашна вредност на 31.12.2022</b>	<b>15.579.447.973</b>						

Në bazë të plasmaneve të reja në bonot shtetërore me normë interesi prej 0.5%, Fondi do të mbledh kamatë në vlerë prej 38.017 mijë denarë, dhe do të paguajë provizion për bankat ndërmjetsuese për ndërmjetësimin e kryer gjatë blerjes së bonove në shumë prej 525 denarë.

Tabela 4: Përmbledhje e planit të të ardhurave nga kamata në bazë të bonove shtetërore dhe provizionit për ndërmjetësimin për blerjen e bonove në 2022

*në denarë*

<b>P Ë R S H K R I M</b>	<b>Gjendja</b>	
	<b>Vlera normale</b>	<b>Vlera aktuale</b>
<b>1.Gjendja e bonove shtetërore (bonot shtetërore 12 mujore)</b>		
Gjendja e bonove shtetërore ne vitin 31.12.2021	14.770.000.000	
Bonot e reja shtetërore në vitin 2022	850.000.000	
Gjendja e bonove shtetërore në vitin 31.12.2022	<b>15.620.000.000</b>	<b>15.579.447.973</b>
<b>2.Kamatë në baze të bonove shtetërore</b>	<b>2022 год.</b>	<b>2023 год.</b>
2.1. Kamatë në bazë të bonove të paarritura nga viti 2021	39.428.152	
2.2. Kamatë në bazë të bonove të reja për vitin 2022:		
- Kamatë e bonove me afat maturimi në vitin 2022	38.016.573	
- Kamatë e bonove me afat maturimi në vitin 2023		40.552.027
<b>Gjithsej :</b>	<b>77.444.725</b>	
<b>3.Provizion për blerjen e bonove të thesarit shtetëror</b>	<b>525.000</b>	

Në përputhje me Rregulloren për politikën e investimeve të Fondit, shuma totale e portofolit të investimeve të Fondit në fund të çdo muaji nuk do të kalojë 99% nga shuma e gjendjes së mjeteve të përgjithshme, gjendja e letrave me vlerë të Fondit dhe kërkesave në bazë të premive. Nën gjendjen e letrave me vlerë merret përputhja e vlerës së bonove shtetërore në evidencën e kontabilitetit të Fondit (gjendja aktuale) në fund të çdo muaji. Investimi i mjeteve bëhet përmes llogarisë së Fondit në BPRMV.

Shuma e gjendjes së plasmanëve në letrat me vlerë dhe gjendja e mjeteve likuide në llogarinë e Fondit paraqet element për përcaktimin e nivelit të synuar (proporcioni i synuar, objektivi) të Fondit, gjegjësisht krahasimi i tij me depozitat e përgjithshme në banka dhe shtëpi kursimesh, anëtare të Fondit, të cilat në vitin 2022 planifikohet të lëvizin prej 4,84% në janar, 2022 deri në 4,75% në dhjetor të vitit 2022.

### **III. Rezultatet e planifikuara të bilancit të Fondit të Sigurimit të Depozitave në 2022**

Aktiviteti afarist i Fondit prezentohet përmes projektimit të rezultateve të bilancit që pritet të realizohen në fund të vitit 2022. Një nga qëllimet kryesore të Fondit është rritja e fitimit në mënyrë që të sigurojë burime financiare të nevojshme për të shtuar kapacitetin e Fondit në kryerjen e funksionit të tij themelor, sigurimi i depozitave të popullatës dhe kompensimi i depozituesve në rast të një ngjarjeje të rrezikshme të njëra nga anëtarët - bankat dhe shtëpitë e kursimit.

Në përputhje me parashikimet për zhvillimet makroekonomike dhe drejtimeve të politikës makroekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, sipas kalendarit për ankandet e bonove shtetërore të organizuara nga Ministria e Financave, si dhe nevojave të parashikuara të Fondit për veprimtari të papenguar të aktivitetit afarist janë projektuar vlerat sipas kategorive në Bilancin e gjendjes dhe Bilancin e suksesit të Fondit për vitin 2022.

#### **III.1 Bilanci i gjendjes**

Bilanci i përgjithshëm në fund të vitit 2022 pritet të arrijë në 16,045 milion denarë.

Projetimi për bilancin e përgjithshëm në fund të vitit 2021 paraqet 15.223 milion denarë gjegjësisht në vitin 2022 parashikohet rritja e bilancit të paraqesë 817.589 mijë denarë ose rritje për 5,4%.

Rritja e planifikuar i bilancit është kryesisht për shkak të pjesëmarrjes së bonove shtetërore në strukturën e përgjithshme të mjeteve.

#### **1. Struktura e mjeteve në planin e Bilancit të gjendjes më 31.12.2022**

Strukturën e mjeteve në gjendjen e Bilancit e përbëjnë katër grupe të kategorive të mjeteve:

1.1 "Mjetet jomateriale", programet softuerë të nevojitura për kryerjen cilësore të veprimtarive afariste;

1.2 "Mjetet materiale" që përfshijnë vlerën e hapësirës afariste personale së bashku me pajisjet(mjete bazë) me të cilat realizohet veprimtaria e afariste e Fondit të Sigurimit të Depozitave;

1.3 "Investime" që mbahen deri në skadim dhe që përbëjnë portofolin e investimeve të Fondit; dhe

1.4 "Mjetet në të holla, kërkesa, përkufizim" që përfshin mjetet që mbahen në BPRMV, në bankat komerciale për nevoja operative dhe në arkën e Fondit. Në të njëjtën kohë, në këtë grup janë përfshirë edhe kufizimet aktive kohore.

Vlerat sipas kategorive të mjeteve nga ana e aktivitetit janë paraqitur në Tabelën 5.

Tabela nr.5 Struktura e mjeteve në plan të gjendjes së Bilancit

*në njëmijë denarë*

Përshkrim	Plani 31.12.2021	%	Gjendja 30.11.2021	%	Projektme 31.12.2021	%	Plani 31.12.2022	%	Indeksi 8/6
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>
<b>MJETE</b>	15.078.036	100,00	15.177.319	100,00	15.222.929	100,00	16.045.291	100,00	105,40
<b>Mjete jomateriale</b>	0	0,00	0	0,00	0	0,00	2.099	0,01	
Softuer dhe të drejta të ngjajshme	0	0,00	0	0,00	0	0,00	2.099	0,01	
<i>Mjete materiale</i>	19.516	0,13	18.983	0,13	19.101	0,13	18.990	0,12	99,42
Patundshmëri	18.779	0,12	18.712	0,12	18.645	0,12	17.836	0,11	95,66
Paisje	737	0,00	271	0,00	456	0,00	1.154	0,01	253,07
<i>Investime</i>	14.638.930	97,09	14.657.332	96,57	14.730.822	96,77	15.579.448	97,10	105,76
Bono dymbëdhjetë mujore	14.638.930	97,09	14.657.332	96,57	14.730.822	96,77	15.579.448	97,10	105,76
<i>Mjete në të holla, kërkesa, përkufizime</i>	419.590	2,78	501.004	3,30	473.006	3,11	444.754	2,77	94,03
Mjete materiale (para)	415.308	2,75	498.145	3,28	470.026	3,09	442.904	2,76	94,23
1. Të holla në banka	415.238	2,75	498.078	3,28	469.960	3,09	442.834	2,76	94,23
2. Kartela afariste	60	0,00	51	0,00	50	0,00	50	0,00	100,00
3. Arkë	10	0,00	16	0,00	16	0,00	20	0,00	125,00
Kërkesa	4.282	0,03	2.859	0,02	2.980	0,02	1.850	0,01	62,08
1. Kërkesa në bazë të premive	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	
2. Kërkesa të tjera	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	
3. Akonotacione të tatimit mbi fitimin	4.282	0,03	2.859	0,02	2.980	0,02	1.850	0,01	62,08
Përkufizime	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	
1. AVR	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	

### 1.1 Mjetet jo materiale

Në kategorinë “mjete jomateriale” janë të përfshira softueri dhe ueb faqja e internetit të Fondit. Për vitin 2022 vlera e përgjithshme e mjeteve jomateriale planifikohet të jetë 2.099 mijë denarë. Në pajtim me konkluzionet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut është e nevojshme të rezervohen mjete financiare për furnizim me softuer me të cilin Fondi i Sigurimit të Depozitave do të kyqet në Platformën Nacionale të Interprobabilitetit.

Gjithashtu, në pajtim me reformat e planifikuara të sistemit të sigurimit të depozitave parashikohet blerje e re ose përmirësim i sistemit ekzistues elektronik i cili shfrytëzohet për realizimin e aktiviteteve afariste të Fondit. Një pjesë e atyre reformave parashikon lidhjen elektronike të Fondit me anëtarët e veta – banka dhe kursimore, mënyrë të re të përllogaritjes së normës së premisë, etj.

## 1.2 Mjete materiale

Kategoria "mjete materiale" paraqet hapsirën afariste, në pronësi të Fondit në të cilin kryhet veprimtaria afariste. Sipas planit për vitin 2022, vlera e tij në fund të vitit 2022 pritet të jetë 19,071 mijë denarë ose rënie në vlerë prej 0,16%.

Në kategorinë e mjeteve materiale përfshihet vlera e pajisjeve. Vlera e paisjeve ekzistuese bie në përputhje me llogaritjet e amortizimit.

Vlera e përgjithshme e pajisjeve planifikohet të jetë 1.235 mijë denarë.

Në pajtim me rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut planifikohet blerja e serverit të ri për arsye të lidhjes me Platëformën Nacionale të Interprobabilitetit, në vlerë prej 62 mijë denarë dhe furnizim me kompjuter të ri me vlerë prej 60 mijë denarë, printerë prej 12 mijë denarësh dhe paisje zyre në vlerë prej 80 mijë denarë për punsimet e reja të cilët planifikohen të realizohen në Fondin e Sigurimit të Depozitave për vitin 2022, si dhe furnizimi me dy kondicionerë të ri në vlerë prej 60 mijë denarësh.

## 1.3 Investimet në letrat me vlerë të cilat ruhen deri në maturim

Në strukturën e Bilancit, në anën e aktivës edhe gjatë vitit 2022, pjesëmarrje dominuese prej 97.07% është planifikuar të ketë kategorinë e mjeteve "investime në letra me vlerë" (projeksioni për 31.12.2021: 96,77%). Të njëjtit planifikohet të rrisin vëllimin me 848,626 mijë denarë ose 5,76% krahasuar me vëllimin e parashikuar në fund të vitit 2021 si rezultat i politikës së vendosur të investimeve prej 99%.

## 1.4 Mjete në të holla, kërkesa, përkufizme

Kategoria e dytë më e madhe e mjeteve nga ana e aktivës janë "Mjete në të holla, kërkesa, përkufizme". Kjo kategori në bilancin e vitit 2022 pritet të arrijë shumën prej 444,754 mijë denarë.

Në suaza të kësaj kategorie, përqindja më e lartë e përfaqësimit i takon paragrafit "mjete në të holla, mjete të dedikuara" e cila përcakton mjetet e dedikuara në vlerë prej 361,000 mijë denarë (projeksioni për 31.12.2021: 400,000 mijë denarë) të dedikuara për pagimin e kompensimit të depozituesve nga Banka Eurostandard SHA Shkup, në falimentim, e shpërndarë në 4 banka komerciale - paguese. Pika – depozita sipas afatizimit në BPRMV në këtë kategori në fund të vitit 2022 do të paraqesë 76,832 mijë denarë.

Mjetet e tjera financiare të Fondit janë 2,003 mijë denarë për depozita në banka komerciale, kartelë biznesi 50 mijë denarë, 5 mijë denarë në arkë dhe 15 mijë denarë në arkën devizore dhe akonotacione të tatimit mbi fitimin në vlerë prej 1,850 mijë denarë.

## 2. Struktura e kapitalit, rezervave dhe detyrimeve në planin e bilancit më 31.12.2022

Struktura e kapitalit dhe rezervave dhe detyrimet në planin e Bilancit të gjendjes më 31.12.2022 përbëhet nga dy kategori:

## 2.1 Kapitali dhe rezervat

Në këtë grup përfshihen kapitali i Fondit të Sigurimit të Depozitave, rezervat e sigurisë dhe fitimet e pashpëndara të fituara në vitin paraprak, të cilat pas llogarisë vjetore në shumën e plotë në përputhje me detyrimin ligjor, shpërndahen në rezervat e sigurisë së Fondit.

## 2.2 Detyrimet rrjedhëse

Në këtë grup përfshihen detyrimet ndaj furnizuesve.

Struktura dhe vlera e planifikuar e këtyre kategorive është paraqitur në Tabelën nr.6

Tabela nr.6 Struktura e kapitalit dhe rezervave dhe detyrimeve në planin e bilancit

*në njëmijë denarë*

Përshkrim	Plani 31.12.2021	%	Gjendja 30.11.2021	%	Projektimi 31.12.2021	%	Plani 31.12.2022	%	Indeksi 8/6
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
<b>KAPITALI DHE REZERVA DHE DETYRIME</b>	15.078.036	100,00	15.177.319	100,00	15.222.929	100,00	16.045.291	100,00	105,40
<i>Kapitali dhe rezerva</i>	14.827.201	98,34	14.753.458	97,21	14.821.315	97,36	15.680.291	97,73	105,80
Kapital i paguar	10.300	0,07	10.300	0,07	10.300	0,07	10.300	0,06	100,00
Fond për siguri	14.781.434	98,03	14.703.929	96,88	14.768.533	97,02	15.619.250	97,34	105,76
Fitim vjetor	35.467	0,24	39.229	0,26	42.482	0,28	50.741	0,32	119,44
<i>Detyrime rrjedhëse</i>	250.835	1,66	423.861	2,79	401.614	2,64	365.000	2,27	90,88
Detyra për dëme	250.835	1,66	423.861	2,79	401.614	2,64	365.000	2,27	90,88
Detyra të tjera	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	
1. Detyra afatshkurte të tjera	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	
2. PVR	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	

## 2.1 Kapitali dhe rezervat

### 2.1.1 Kapitali

Kapitali i Fondit në vlerë prej 10.3 milion denarë është pronë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në vitin 2022 është planifikuar të mban nivelin e viteve të mëparshme. Në strukturën e kapitalit, rezervave dhe detyrimeve parashihet të merr pjesë me 0.06%.

### 2.1.2 Rezervat e sigurisë

Kategoria "fondi i sigurisë" parashihet të arrijë shumën prej 15,619 milion denarë ose të rritet për 5,76%, gjegjësisht për 850,7 milion denarë do të tejkalojë nivelin e projektuar për vitin 31.12.2021.

### 2.1.3 Fitimi i akumuluar

Fitimi nga aktiviteti i biznesit në vitin 2022 do të rezultojë me fitim prej 50,741 mijë denarë (projektim për vitin 2021:42.482 mijë denarë) ose rritje prej 19,44%.

Fitimi që e realizon Fondi është si rezultat i intresit të fituar nga investimet në letra me vlerë.

## 2.2. Detyrimet rrjedhëse

### 2.2.1 Detyrimet për dëmet

Detyrimet për dëmet në vitin 2022 do të arrijnë shumën prej 365,000 mijë denarë në bazë të kompensimit të depozituesve të Bankës Eurostandard SHA Shkup në falimentim (projektimi për 31.12.2021: 401,614 mijë denarë).

## III.2 Plani i Bilancit të suksesit për periudhën 01.01 deri më 31.12.2022

Efektet reale të planifikimit dhe realizimit të aktivitetit afarist për vitin 2022 pritet të ndikohen në të ardhurat nga Bilanci i suksesit, dhe veçanërisht në realizimin e fitimit. Në bazë të parametrave të parashikuar në të gjitha segmentet e funksionimit të Fondit me planin për vitin 2022, pritet:

- Të hyrat e përgjithshme të realizohen në vlerë prej 77,445 mijë denarë (projektimi për vitin 2021: 62,907 mijë denarë) ose rritje prej 23.11%. Të hyrat të cilat i realizon Fondi vinë nga norma e interesit të bonove shtetërore, të cilat për vitin 2022, pritet të jenë 0.5%.
- Shpenzimet e përgjithshme të arrijnë shumën prej 21,056 mijë denarë (projektimi për vitin 2021: 15,700 mijë denarë), ose rritje prej 34,11%; gjatë së cilës, efekti pozitiv do të rezultojë me:
  - Fitimi neto prej 50,741 mijë denarë (projektimi për vitin 2021: 42.482 mijë denarë). Sipas vlerave të përcaktuara të të gjitha pozicioneve nga bilanci i suksesit të planifikuar për vitin 2022, të ardhurat gjenerohen nga interesi i realizuar në bazë të investimit në bonot shtetërore dymbëdhjetë mujore, ndërsa shpenzimet realizohen përshkak të kryerjes së veprimtarisë pa pengesë.

### 1.1. Të ardhura

Struktura e të ardhurave të cilat do t'i realizon Fondi në vitin 2022 janë të prezantuar në Tabelën nr.7

Tabela nr.7 Struktura e të ardhurave në planin e suksesit të bilancit

*në njëmijë denarë*

Përshkrim	Plani 01.01.2021 - 31.12.2021	%	01.01.2021 - 30.11.2021	%	Projektimi 01.01. 2021 - 31.12.2021	%	Plani 01.01.2022 - 31.12.2022	%	Indeksi 8/6
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
<b>TË HYRAT</b>	<b>60.279</b>	<b>100,00</b>	<b>56.845</b>	<b>100,00</b>	<b>62.907</b>	<b>100,00</b>	<b>77.445</b>	<b>100,00</b>	<b>123,11</b>
1. Bono shtetërore - gjashtë mujore	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	
2. Bono shtetërore - dymbëdhjetë mujore	60.269	99,98	56.807	99,93	62.869	99,94	77.445	100,00	123,18
3. Depozita të paafatizuara BPRMV	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	



4. Depozitë të paafatizuara Banka komerciale	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	
5. Kamatë ndëshkuese në bazë të premive	10	0,02	38	0,07	38	0,06	0	0,00	0,00
6. Kamatë(inter) nga bankat paguese	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	

Në vitin 2022, të ardhurat nga kamata e bonove shtetërore të thesarit në shumën e planifikuar prej 77,445 mijë denarë, marrin pjesë me 100% në strukturën e të ardhurave të përgjithshme. Të hyrat e përgjithshme pritet të jenë më të larta për 23.11%, krahasuar me të hyrat e projektuara në fund të vitit 2021, gjegjësisht të rriten për 14,538 mijë denarë. Në vitin 2022 është planifikuar të blihen bono shtetërore dymbëdhjetë mujore me normë të interesit vjetor prej 0.5%.

## 2. Shpenzimet

Ana e shpenzimeve të bilancit të suksesit përbëhet nga gjashtë kategori të shpenzimeve. Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2022 do të jenë në vlerë prej 25.237 mijë denarë. Shpenzimet e projektuara për vitin 2021 në vlerë prej 15,700 mijë denarë do të rriten për 60,75% në shpenzimet për vitin 2022.

Rritja e shpenzimeve nuk do të ndikoj në rezervat e sigurisë dhe të hyrat e Fondit të Sigurimit të Depozitave.

Mjetet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të reja të planifikuara sigurohen nga mjete e likuiditetit të Fondit dhe të njejtat nuk e kalojnë pragun e lejuar prej minimum 1% të mjeteve të përgjithshme në të holla të Fondit në nivel vjetor, në pajtim ligjislacionin.

Tabela nr. 8 Struktura e shpenzimeve në planin e Bilancit të suksesit

Përshkrim	Plani 01.01.2021 - 31.12.2021		01.01.2021 - 30.11.2021		Projektme 01.01. - 31.12.2021		Plani 01.01.2022 - 31.12.2022		Indeksi 8/6
		%		%		%		%	
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>
<b>SHPENZIME</b>	20.861	100,00	13.255	100,00	15.700	100,00	21.056	100,00	134,11
1. Shpenzime për shërbime	2.466	11,82	760	5,73	871	5,55	1.858	8,82	213,32
2. Amortizim dhe zhvlerësim	1.014	4,86	860	6,49	938	5,97	1.541	7,32	164,29
3. Shpenzime materiale	864	4,14	484	3,65	630	4,01	937	4,45	148,73
4. Shpenzime tjera nga puna	1.747	8,37	1.262	9,52	1.331	8,48	1.706	8,10	128,17
5. Shpenzime për të punësuarit	14.315	68,62	9.455	71,33	11.401	72,62	14.489	68,81	127,09
6. Shpenzime në bazë të investimeve financiare	455	2,18	434	3,27	529	3,37	525	2,49	99,24

Në vitin 2022 kategorija- shpenzime për të punësuar do të paraqesë 14,489 mijë denarë, ose rritje prej 147 mijë denarë në krahasim me planin e vitit 2021.

Kategorija shpenzime për të punësuar i përfëshin punësimet e parashikuara (të parashikuara në palnin e vitit 2021) për një person përgjegjës për TIK, një pasturuese si dhe punësimin e një këshilltari për kontabilitet si zëvendësim të kolegut i cili ka shkuar në pension. Përskaj këtyre punësimeve të planifikuara, gjithashtu planifikohet punësim i një bashkëpunatori të ri.

Në kategorinë e shpenzime janë të llogaritura edhe shpenzimet për pagesën e kompenzimit të njëhershëm për pensionim, pagesa e çmimit jubilar dhe regresit për pushim vjetor.

Kategorija „shpenzime për shërbime” do të arri vlerën 5.801 mijë denarë ose 3.334 mijë denarë më tepër se sa në planin e vitit 2021. Në Planin financiar për vitin 2021, vlera e kësaj kategorije ishte e planifikuar të jetë 2.466 mijë denarë, por për arsye të pandemisë botërore dhe krizës së shkaktuar nga smundja ngjitëse COVID-19 e cila vazhdoi edhe në vitin 2021 përqindja më e madhe e shpenzimeve të kësaj kategorije nuk u realizuan dhe, realizimi në fund të viti 2021 do të paraqesë 871 mijë denarë.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve të cilat ishin planifikuar për vitin 2021, planifikohen përsëri edhe për vitin 2022. Tabela 9 ofron një paraqitje analitike të të gjitha shpenzimeve për shërbime në Fondin e Sigurimit të Depozitave.

Tabela nr.9 Struktura e shpenzimeve dhe shërbimeve

*në denarë*

Përshkrim	Plani 01.01.2021 - 31.12.2021	Gjithsej 01.01.2021 - 30.11.2021	Projektimi 01.01.2021 - 31.12.2021	Plani 01.01.2022 - 31.12.2022	Indeksi 5/4
1	2	3	4	5	6
<b>Shpenzime për shërbime</b>	<b>2.465.950</b>	<b>760.192</b>	<b>871.181</b>	<b>1.858.206</b>	<b>213,30</b>
Shpenzime për shërbime ndaj personave fizik	0	86.868	109.090	66.666	61,11
Provizion për qarkullimin e paguar – BPRMV	24.000	17.000	22.000	24.000	109,09
Provizion për qarkullimin e paguar - NLB Bankë	32.000	33.571	35.971	36.000	100,08
Provizione bankare -Bankat komerciale	2.000	2.674	8.227	10.000	121,55
Premi për sigurim	60.000	23.743	23.743	30.000	126,35
Sigurim Kasko	25.000	21.155	21.155	25.000	118,18
Shpenzime për shërbime telekomunikative-telefoni	472.000	126.747	151.747	236.000	155,52
Shpenzime për shërbime telekomunikative-postale	3.000	4.146	6.146	7.000	113,90
Shpenzime për transport -taksi	3.000	514	2.014	5.400	268,12
Shërbime për mirëmbajtje të hapësirave/pajisjeve	354.000	18.010	19.210	90.000	468,51
Renovim të hapësirës	70.800	0	0	0	
Mirëmbajtje të softuerit	177.000	162.250	177.000	177.000	100,00
Mirëmbajtje të rrjetit dhe kompjuterëve	177.000	0	0	177.000	
Hostim i faqes së internetit	11.800	4.600	4.600	11.800	256,52
Shpenzime për marketing	70.800	920	920	35.400	3.847,83
UEB faqe e re	141.600	18.700	18.700	0	0,00
Shpenzime për reprezentacion	30.000	21.411	30.000	40.500	135,00
Shpenzime për shërbime hotelierike	60.000	0	14.500	67.500	465,52
Organizim të ngjarjes për Ditën e kursimit	212.400	0	0	191.160	

Organizim i ngjarjes në lidhje me sigurimin e depozitëve	141.600	0	0	193.500	
Stres test në ndonjë bankë	141.600	0	0	0	
Tim billding	0	0	0	127.440	
Shpenzime për certifikatin e standard ISO 9001	0	0	0	0	
Shpenzime për mbikëqyrje kontrolluese në pajtim me ISO 9001:2015	106.200	102.140	102.140	102.140	100,00
Servisimi i PP aparateve	2.950	0	3.000	3.000	100,00
Regjistrimi i automjetit	18.000	19.448	19.448	20.000	102,84
Shpenzime për taksë rrugore	60.000	36.080	41.080	60.000	146,06
Shpenzime për parkim	6.000	225	500	21.600	4.320,00
Shpenzime të tjera për automjet	3.200	4.100	4.100	4.100	100,00
Servisimi i automjeteve	60.000	46.902	46.902	60.000	127,93
Shpenzime për goma	0	8.988	8.988	36.000	400,53

\* shumat në tabelë janë të prezantuara me përfshirje të TVSH-së

Në vitin 2022 për pikën Rinovim i hapsirës janë planifikuar shpenzime në vlerë prej 3,701 mijë denarë, prej të cilave 60 mijë denarë janë planifikuar për përpunimin e dokumentacionit projektues, ndërsa 3.075 mijë denarë planifikohen për realizimin e rinovimit.

Shpenzimet e tjera të kësaj kategorije janë shpenzime për shërbime telekomunikative – 236 mijë denarë. Në pajtim me Ligjin për furnizime publike ( të datës 01.04.2019) furnizimi me shërbime telekomunikative realizohet përmes shpalljes së tenderit për furnizim me shërbime telekomunikative. Fondi ka nevojë për : linjë fikse, telefonë mobil, internet për Fondin dhe TV.

Pakot e shërbimeve telekomunikuese të cilat ofrohen në treg dhe që i përmbushin nevojat e Fondit, lidhen në periudhë kohore prej 2 vitesh. Nga këtu, është e nevojshme që në shpenzimet e shërbimeve të rezervohen mjete në vlerën e një kontrate 2-vjeçare ose 236 mijë denarë për një vit.

Gjatë vitit 2022, rezervohen 100 mijë denarë për furnizim të shërbimeve për riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të hapësirave të Fondit (mirëmbajtjen e ujit, rrymës, instalimit të nxemjes, lysterjes dhe të ngjajshme). Shpenzime e rregullta për mirëmbajtjen e softuerit paraqesin 177 mijë denarë. Shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit dhe kompjuterave planifikohet të jetë 177 mijë denar. Gjatë vitit 2022 planifikojmë të realizojmë aktivitete promovuese dhe edukative në vlerë prej: 1) organizimi i ngjarjejes „ Dita e kursimit” – 212,4 mijë denarë , 2) organizimi i një ngjarjeje për promovimin e sigurimit të depozitave - 215 mijë denarë dhe 3) „tim building” për të punësuarit e Fondit të Sigurimit të Depozitave – 141,6 mijë denarë.

Shpenzimet e certifikimit për standardin ISO prej 102 mijë denarë i referohet certifikimit ISO i cili është i vlefshëm për 3 vjet, por rishikohet çdo vit dhe në përputhje me rrethanat paguhet për çdo vit.

Për hostimin e ueb faqes së FSD janë rezervuar 11,8 mijë denar. Gjithashtu janë planifikuar edhe mjete për marketing në vlerë prej 60 mijë denarë.

Në këtë kategori janë planifikuar edhe shpenzime për reprezentim -81 mijë denrë dhe shpenzime për shërbime hotelerike në vlerë prej 135 mij denarësh. Në rast se lejon gjendja epidemiologjike,

këto mjete do të shfrytëzohen për mbajtjen e takimeve me prezencë me mysafir- kolegë nga rajoni dhe vendet e EU-së, si dhe takime me përfaqësuesët e institucioneve nga sektori financiar, për arsye të forcimit të bashkëpunimit dhe ndarjes së përvojave nga fusha e mbrojtjes së depozitave.

Shpenzime për parking të automjetit zyrtar janë planifikuar në vlerë prej 24 mijë denarë. Shpenzimet tjera nga kjo kategori „shpenzime për shërbime” dedikohen shpenzimeve të rregullta për regjistrim 20 mijë denarë, servisim të automjetit 60 mijë denar dhe goma 40 mijë denar.

Kategoria "amortizim dhe sigurim" në vitin 2022 parashikohet të jetë 1.554 mijë denarë. Për "shpenzimet materiale" parashikohet rritje prej 959 mijë denarë (projektimi 2021:629 mijë denar)

Në këto shpenzime janë llogaritur shpenzimet për furnizimin me materiale zyre 60 mijë denar, blerje të USB-ve 5 mijë denar, tonerë 60 mijë denarë, mjete higjienike 60 mijë denarë . Shpenzimet e energjisë elektrike, planifikohet të rriten në 200 mijë denrë. Në këtë kategori planifikohen edhe shpenzimet e nxemjes me parno, gazeta dhe revista, karburant për automjetin etj.

Në tabelën 10 është dhënë tabelë analitike të shpenzimeve materiale.

Tabela numër 10 struktura e shpenzimeve materiale

Përshkrim	në denarë				
	Plani 01.01.2021 - 31.12.2021	Gjithsej 01.01.2021 - 30.11.2021	Projekttime 01.01.2021 - 31.12.2021	Plani 01.01.2022 - 31.12.2022	Indeksi 5/4
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>Shpenzime materiale</b>	864.000	483.464	629.359	959.060	152,39
Shpenzime për material të zyrës	70.800	28.040	35.000	70.800	202,29
Shpenzime për USB	0	2.250	2.250	5.000	222,22
Shpenzime për toner	70.800	14.720	18.720	70.800	378,21
Shpenzime për mjete higjienike	70.800	24.012	32.012	70.800	221,17
Shpenzime për materiale të tjera të zyrës	0	180	180	0	0,00
Shpenzimet e rrymës	177.000	80.296	110.296	200.000	181,33
Shpenzimet e ujit	12.000	11.050	13.050	15.000	114,94
Shpenzimet e nxemjes qendrore	300.000	189.631	256.155	300.000	117,12
Shpenzimet për shtypjen e formularëve	1.000	5.180	5.180	6.000	115,83
Shpenzimet për gazeta dhe revista	20.000	25.280	25.280	36.580	144,70
Mbeturina elektronike	0	0	0	7.080	
Shpenzimet për karburant	141.600	102.825	131.236	177.000	134,87

\*vlerat në tabelë janë të prezentuara me TVSH të përfshirë

Kategoria "shpenzime të tjera operative" ka një vlerë prej 1,933 mijë denarë ose rritje prej 185 mijë denarë nga të planifikuarat për vitin 2021. Në këtë grup të shpenzimeve llogariten shpenzimet për anëtarësim në Forumin Europian të Sigurimit të Depozitave, i cili për vitin 2022 arrin në 4000

euro për vendet jashtë Bashkimit Europian. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar në kuvendin vjetor të EFDI, mbledhje të rregullta të Forumit Regjional të vendeve të Ballkanit anëtare të EFDI, shpenzimet e udhëtimit dhe vendosjes së punonjësve në mbledhjet e lartpërmendura gjatë vitit 2021 nuk ishin realizuar për shkak të pandemisë, por janë të planifikuara për vitin 2022. Shpenzime të tjera të kësaj kategorie janë shpenzimet për zhvillim profesional, sigurim e një objekt afarist, dezinfektimi dhe shtesat për anëtarët e Bordit Drejtues. Gjithashtu, me rekomandim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut është planifikuar edhe angazhimi i punëtorëve vullnetar për shpenzimet e të cilëve janë siguruar mjete në vlerë prej 55,5 mijë derë. Projektimi për realizim deri në fund të vitit 2021 të kësaj kategorie ka vlerë prej 1.331 mijë denarë.

Në tabelën nr. 11 është paraqi përshkrim analitik i shpenzimeve të tjera të punës

Tabela nr.11 Struktura e shpenzimeve të tjera të punës

<i>në denarë</i>					
	Plani 01.01.2021 - 31.12.2021	Gjithsej 01.01.2021 - 30.11.2021	Projektimi 01.01.2021 - 31.12.2021	Plani 01.01.2022 - 31.12.2022	Indeksi 5/4
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>Shpenzime të tjera nga puna</b>	<b>1.747.524</b>	<b>1.262.049</b>	<b>1.331.294</b>	<b>1.932.839</b>	<b>145,18</b>
Anëtarësim në Forumin Europian Të Siguruesëve të Depozitave	247.200	247.200	247.200	247.200	100,00
Anëtarësim në Institutin e Kontabilistëve të autorizuar	0	2.400	2.400	2.400	100,00
Mëditje për udhëtime zyrtare në vend	0	0	0	0	
Mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit	100.000	14.438	14.438	100.000	692,62
Shpenzime rruge për udhëtime zyrtare në vend	0	0	0	0	
Shpenzime rruge për udhëtime zyrtare jashtë vendit	150.000	616	616	150.000	24.350,65
Shpenzime rruge – taksi transport jashtë vendit	6.000	0	0	12.000	
Shpenzime për shfrytëzimin e veturës personale për qëllime zyrtare	0	19.743	19.743	0	0,00
Kompenzim për qëndrim (vendosje në hotel) gjatë udhëtimit zyrtar brenda vendit	0	0	0	0	
Kompenzim për qëndrim (vendosje në hotel) gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit	200.000	15.177	15.177	200.000	1.317,78
Kompenzim për anëtarët e Bordit drejtues	693.324	635.548	693.325	693.324	100,00
Shpenzime për avansim profesional	60.000	45.140	50.000	200.000	400,00
Shpenzime për revizio	188.800	188.800	188.800	188.800	100,00
Mbikëqyrje 24 orëshe e objektit	41.300	32.450	38.350	41.300	107,69
Shërbime për shfrytëzim të sefit	0	6.962	6.962	2.360	33,90
Shërbime të tjera jomateriale - sigurim udhëtimit	2.000	400	400	3.000	750,00
Shpenzime të tjera të punës – provizion CR, CDHV	6.000	3.891	3.891	6.000	154,20
Shpenzime të tjera të punës – nënshkrim elektronik	5.000	9.220	9.220	15.000	162,69
Shpenzime për shërbime publikimi	0	5.664	6.372	8.000	125,55
Shpenzime të tjera të punës – shërbime noteriale	2.000	0	0	2.000	
Shërbime të tjera të punës - dezinfektim	5.900	0	0	5.900	

Shërbime të tjera të punës – kontrollë sistematike	40.000	34.000	34.000	0	0,00
Shpenzime të tjera të punës		400	400	55.555	13.888,75

Vlera e kategorisë „ Shpenzime në bazë të investimeve financiare ” deri në fund të vitit 2022 do të paraqesë 525 mijë denarë.

### 3. Fitimi neto për vitin 2022

Në përputhje me të hyrat dhe shpenzimet e punës së Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2022 pritet të arrihet fitimi neto në vlerë prej 60,494 mijë denarë ose rritje prej 42,49%.

Tabela 12. Fitimi neto

							<i>në denarë</i>
Përshkrim	Plani 01.1.2021 - 31.12.2021	Gjithsej 01.01.2021 - 30.11.2021 31.12.2021	Projektimi 01.01.2021 - 31.12.2021	Plani 01.01.222 - 31.12.2022	Plani 2022 / Projektim 2021 (%)	Plani 2022 / Projektim 2021 (%)	Dallimi në vlera absolute 5/4
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>
GJITHSEJ TË HYRA	60.278.621	56.844.884	62.906.660	77.444.725	123,11	128,48	14.538.065
GJITHSEJ SHPENZIME	20.861.141	13.249.572	15.699.873	25.236.384	160,74	120,97	9.536.511
Fitimi bruto	39.417.480	43.590.312	47.206.787	52.208.341	110,59	132,45	5.001.554
Tatimi mbi fitimin	3.949.848	4.360.958	4.724.684	5.240.274	110,91	132,67	515.590
<b>FITIMI NETO</b>	<b>35.467.632</b>	<b>39.229.354</b>	<b>42.482.103</b>	<b>46.968.067</b>	<b>110,56</b>	<b>132,43</b>	<b>4.485.964</b>

Në pajtim me Ligjin dhe Statutin e Fondit të Sigurimit të Depozitave, fitimi neto i cili pritet të realizohet në vitin 2022 do të shpërndahet në „ rezervat e sigursë” së Fondit për arsye të rritjes së fuqisë financiare, me çka do të mundësohet siguri dhe besim më i madh tek depozitorët.

\*\*\*

Të gjitha segmentet dhe pozitat e projektuara në bilancet e planit Financiar të Fondit për Sigurim e Depozitave për vitin 2022, bazohen në analiza konçize dhe parametra reale. Nga këtu, edhe pritjet janë reale që materiali i lëndës do të pranohet plotësisht sipas mënyrës dhe vlerave të implementuara dhe të prezentuara.

Наш број 02 – 141/1  
Скопје, 03.03.2022 година

